



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PRESEDNIK

RREGULLORE (P) NR. 02/2018
PËR TITULLIN: AMBASADOR I VULLNETIT TË MIRË

Prishtinë, 30 mars 2018



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PRESEDNIK

Presidenti i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 84 (28) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 47, 25 janar 2009), neneve 5 dhe 18 të Ligjit Nr. 04/L-070 për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 02, 20 janar 2012), nenit 3 (4) të Rregullores (P) Nr. 02/2016 për Strukturën Organizative të Presidencës (08.09.2016), si dhe duke marrë parasysh nenin 4 (2) të Rregullores (P) Nr. 04/2016 për llojet e dekoratave dhe procedurat për dhënien dhe revokimin e tyre (21.12.2016), nxjerr:

**RREGULLORE (P) NR. 02/2018 PËR TITULLIN: AMBASADOR I
VULLNETIT TË MIRË**

KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo Rregullore përcakton kriteret dhe procedurat për dhënien dhe revokimin e Titullit: Ambasador i Vullnetit të Mirë.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Kjo Rregullore zbatohet gjatë procesit të dhënies apo revokimit të titullit: Ambasador i Vullnetit të Mirë.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **President** – Presidenti i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. **Ministër** – Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme;
 - 1.3. **Ambasador i Vullnetit të Mirë** – *Goodwill Ambassador*, i cili është titull, të cilin e jep Presidenti;

- 1.4. **Revokim i titullit** – heqja e së drejtës dikujt për bartjen e titullit të dhënë nga Presidenti;
 - 1.5. **Departament** – Departamenti për Çështje Juridike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në kuadër të Zyrës së Presidentit;
 - 1.6. **Zyrtari për dekorata** – Zyrtari përkatës për dekorata në kuadër të Departamentit;
 - 1.7. **Komision** – Komisioni Vlerësues për Dekorata i emëruar nga Presidenti në pajtim me Rregulloren (P) Nr. 05/2016 për punën e Komisionit Vlerësues për Dekorata (21.12.2016);
 - 1.8. **Ligj** – Ligjin Nr. 04/L-070 për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 02, 20 janar 2012);
 - 1.9. **Rregullore** – Rregullore (P) Nr. 04/2016 për llojet e dekoratave dhe procedurat për dhënien dhe revokimin e tyre (21.12.2016).
2. Shprehjet tjera, të përdorura në këtë Rregullore, kanë kuptimin e njëjtë si në përkufizimet e Ligjit dhe Rregullores.

KAPITULLI II – KRITERET DHE PROCEDURAT PËR DHËNIEN E TITULLIT: AMBASADOR I VULLNETIT TË MIRË

Neni 4 Kriteret

1. Titulli: Ambasador i Vullnetit të Mirë u jepet personave, të cilët:
 - 1.1. avokojnë për çështje të caktuara në një vend apo në ndonjë organizatë, në bazë të vullnetit të tyre të mirë;
 - 1.2. kanë qenë dhe janë në shërbim të interesit të përgjithshëm të shoqërisë dhe të Republikës së Kosovës;
 - 1.3. kanë dhënë dhe do të japin kontribut në zhvillimin e artit, kulturës, shkencës, sportit dhe/apo diplomacisë si dhe në fusha të tjera të jetës publike;
 - 1.4. promovojnë fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës;
 - 1.5. mbështesin anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Organizata dhe Mekanizma Ndërkombëtarë; si dhe
 - 1.6. mbështetin procesin e njohjes së Republikës së Kosovës.

Neni 5 Dhënia e Titullit

Presidenti me vetiniciativë mund të japë Titullin: Ambasador i Vullnetit të Mirë.

Neni 6 Propozimi për Titull

1. Propozimi për Titull: Ambasador i Vullnetit të Mirë, mund të bëhet nga Ministri.

2. Propozimi i Ministrit për Titullin: Ambasador i Vullnetit të Mirë, i drejtohet Presidentit me shkrim, dhe duhet t'i bashkëngjitet:
 - 2.1. arsyetimi përkatës, ku paraqiten arritjet dhe meritat e veçanta të të propozuarit;
 - 2.2. pëlqimi i të propozuarit, si dhe
 - 2.3. biografia e të propozuarit.
3. Propozuesi është përgjegjës për të gjitha të dhënat dhe dëshmitë e paraqitura për të propozuarin.
4. Propozimi i Ministrit, i cili i drejtohet Presidentit, i bartet Departamentit për procedurë të mëtutjeshme, përveç nëse Presidenti nuk vendos ndryshe.

Neni 7 **Shqyrtimi i propozimit për Titull**

1. Propozimet e Ministrit, të cilat i drejtohen Presidentit, për dhënien e Titullit: Ambasador i Vullnetit të Mirë, Departamenti i paraqet për shqyrtim në Komision, përveç nëse Presidenti nuk vendos ndryshe.
2. Komisioni, në pajtim me Ligjin dhe Rregulloren (P) Nr. 05/2016 për punën e Komisionit Vlerësues për Dekorata (21.12.2016), shqyrton dhe vlerëson propozimin dhe përgatit rekomandimin për Presidentin.
3. Në rastet kur rekomandimi miratohet nga Presidenti, Departamenti përgatit vendimin dhe certifikatën.

Neni 8 **Mandati**

Titullit: Ambasador i Vullnetit të Mirë jepet për një periudhë prej dy (2) viteve, me mundësi të vazhdimit me pëlqimin e dy anshëm, duke u bazuar në arritjet e realizuara dhe vullnetin e mirë të tyre.

Neni 9 **Dorëzimi i Titullit**

1. Titulli: Ambasador i Vullnetit të Mirë dorëzohet sipas ceremonisë, të cilën e vendos Presidenti.
2. Pjesë e ceremonisë për dhënien e Titullit: Ambasador i Vullnetit të Mirë mund të jetë edhe Ministri, në rastet kur propozimet janë bërë nga ai.
3. Presidenti mund të autorizojë Ministrin apo ndonjë person tjetër për organizimin e ceremonisë për dhënien e Titullit: Ambasador i Vullnetit të Mirë.

Neni 10 **Revokimi i Titullit**

1. Revokimi i Titullit: Ambasador i Vullnetit të Mirë mund të bëhet në rastet si në vijim:
 - 1.1. nëse personi, që e ka marrë këtë Titull kryen vepra, që e bëjnë të pa denjë për bartjen e tij;

- 1.2. nëse personi, që e ka marrë këtë Titull vepron në kundërshtim me rendin publik dhe moralin;
 - 1.3. nëse personi, që ka marrë këtë Titull kryen vepra të tjera, që bien ndesh me rregullat ndërkombëtare, Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi të Republikës e Kosovës.
2. Presidenti me vendim revokon Titullin: Ambasador i Vullnetit të Mirë, sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen.

KAPITULLI III - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 11 Evidenca

1. Titulli: Ambasador i Vullnetit të Mirë, që jep Presidenti evidentohet në një regjistër të veçantë, i cili administrohet dhe përditësohet nga Departamenti, respektivisht nga Zyrtari për Dekorata.
2. Zyrtari për Dekorata mban evidencë edhe në rastet e revokimit të Titullit.

Neni 12 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit me dekret nga ana e Presidentit.

Hashim THAÇI

President i Republikës së Kosovës

Prishtinë, 30 mars 2018.

**Miratuar me dekretin Nr. DNJ-02-2018,
datë 30.03.2018 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi**